



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 63 Prot

Shkodër, më 05.01.2022

VENDIM

Nr. 01, datë 05.01.2022

**“PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS DHE TË INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË
SHKODËR ”**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 8; të shkronjës “b”, pika 1.1, të nenit 9; të pikës 1, të nenit 51; të shkronjës “ç” të nenit 54; të pikës 2 dhe pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ; VKM 717 datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar, VKM nr. 1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ; VKM nr. 1149 datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr. 175 dt. 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”; VKM nr. 187 dt. 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” të ndryshuar; VKB nr.6 dt. 30.01.2018 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë” të ndryshuar; Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.01.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë së Shkodrës”;

VENDOSA :

1. Miratimin e strukturës të nëpunësve dhe punonjësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër, sipas tabelave bashkangjitur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër dhe institucionet e varësisë.
3. Ngarkohet Sektori i Protokoll Arkivit për shpërndarjen të gjithë drejtorive të administratës dhe institucioneve të varësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Voltana Ademi

